



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika c, e lidhur me nenin 34 paragrafi 34.4 të Ligjit, Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, („Fletorja zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të MAPL, Nr. 2008/08, për Organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, si dhe në bazë të nenit 10 parag. 2 pika 3 të Statutit të Komunës së Klinës, Nr. 01-110-1232/2010, i miratuar më dt. 31 mars 2010, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e vetë të rregullt, të I-ën me radhë për vitin 2015, të mbajtur më dt. 30.01.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratim të Rregullores për Organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Klinës

I

Miratohet Rregullorja për Organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Klinës.

II

Rregullorja si në pikën 1 të këtij vendimi, rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis Komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, duke formuar këshillat lokale si trupa mbështetës të organeve të Komunës, që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike komunale.

III

Vendimi hyn në fuqi me miratimin nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës për konfirmim të ligjshmërisë sipas nenit 81.4 të LVL.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-862 2015
Klinë, më 30.01.2015



KRYESUESI,
Dr. Haxhi Ibishi